

# Strategjia e zbatimit të raportimit të qëndrueshmërisë nga ndërmarrjet në Ukrainë

Liudmyla HAPONENKO

3 dhjetor 2024



**CFRR** >>  
Centre for Financial  
Reporting Reform




**PULSAR** 

Public Sector Accounting and Reporting Program

PULSAR Program is co-funded by:

 Federal Ministry  
Republic of Austria  
Finance

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
State Secretariat for Economic Affairs SECO

# Objektivat Botërore për Zhvillim të Qëndrueshëm



Në shtator 2015, 193 vende të botës miratuan Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ) deri në 2030. Pra, shumica e shteteve të planetit vendosën të bashkojnë forcat për t'i kapërcyer problemet botërore të njerëzimit: varfërinë, urinë, barazinë, standardin e ulët të jetës, ndotjen e natyrës etj. U miratuan gjithsej 17 objektiva botërorë:



# Përmbajtja



- ✓ Konteksti i zbatimit të raportimit të qëndrueshmërisë nga ndërmarrjet
- ✓ Aktet ligjore që funksionojnë në sferat përkatëse
- ✓ Qëllimi i Strategjisë
- ✓ Objektivat strategjike dhe mënyrat për t'i arritur
- ✓ Fazat kryesore të zbatimit të Strategjisë
- ✓ Rezultatet e pritura të zbatimit të Strategjisë

# Strategjia e zbatimit të raportimit të qëndrueshmërisë nga ndërmarrjet



Më 18 tetor 2024, Kabineti i Ministrave i Ukrainës miratoi Urdhrin nr. 1015

“Për miratimin e Strategjisë për zbatimin e raportimit të qëndrueshmërisë nga ndërmarrjet”

Me Urdhrin nr. 1015 u miratua “Plani i punës për zbatimin e strategjisë në 2024-2026”. Përcakton hapat e pare të zbatimit të raportimit të qëndrueshmërisë



# Konteksti i zbatimit të raportimit të qëndrueshmërisë nga ndërmarrjet



## 1. Objektivat Botërorë për Zhvillim të Qëndrueshëm

Ukraina, si vend anëtar i OKB-së, iu bashkua procesit botëror të zhvillimit të qëndrueshëm pas miratimit në 2015 në samitin e OKB-së të dokumentit final “Ta transformojmë botën: program në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm deri në vitin 2030”, ku u miratuan 17 objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm deri në vitin 2030.

## 3. Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm në Ukrainë

Vendim i Presidentit të Ukrainës, datë 30 shtator 2019, nr. 722 “Për objektivat për zhvillim të qëndrueshëm të Ukrainës deri në 2030” përcakton objektivat për zhvillim të qëndrueshëm për periudhën deri në vitin 2030, që janë udhëzime për përgatitjen e projekt-dokumenteve parashikuese dhe programore, projekt-akteve rregullatore dhe ligjore për të siguruar drejtpeshim të dimensioneve ekonomike, shoqërore dhe ekologjike të zhvillimit të

## 2. Marrëveshja e asocimit

Në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes së asocimit në vitin 2017, Ukraina mori përsipër ta harmonizojë legjislacionin e brendshëm me kërkesat e legjislacionit evropian, në veçanti në fushat e kontabilitetit dhe auditimit

## 4. Marrja e statusit të vendit kandidat nga Ukraina

Pas marrjes së statusit të vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian më 23 qershor 2022, përputhja e legjislacionit të Ukrainës me kërkesat e legjislacionit evropian u bë një prej detyrimeve kryesore për Ukrainën në këtë proces

# Aktet ligjore që rregullojnë raportimin e qëndrueshmërisë në BE



1

Direktiva (BE) 2022/2464 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14 dhjetor 2022, për ndryshimin e Rregullores (BE) nr. 537/2014, Direktivës 2004/109/KE, Direktivës 2006/43/KE dhe Direktivës 2013/34/BE, për raportimin e qëndrueshmërisë nga shoqëritë tregtare

2

Rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) 2023/2772, datë 31 korrik 2023, për plotësimin e Direktivës 2013/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me standardet e raportimit të qëndrueshmërisë

3

Direktiva 2013/34/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, për pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet e lidhura të disa llojeve të caktuara ndërmarrjesh

4

Direktiva 2006/43/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 17 maj 2006, për auditimet ligjore të pasqyrave financiare vjetore dhe pasqyrave të konsoliduara, ndryshimin e Direktivave të Këshillit 78/660/KEE dhe 83/349/KEE dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 84/253/KEE

5

Rregullorja (BE) nr. 537/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 prill 2014, për kërkesat e veçanta lidhur me auditimin ligjor të njësive ekonomike me interes publik dhe për shfuqizimin e Vendimit të Komisionit nr. 2005/909/KE



# Raportimi për treguesit e veçantë përpara miratimit të strategjisë



2015

Ukraina iu bashkua procesit të sigurimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe filloi procesin gjithëpërfshirës të përshtatjes së OZHQ-ve. Secili objektiv global u konsiderua se merrte në konsideratë veçantitë e zhvillimit kombëtar

2017

Raporti kombëtar “Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm: Ukraina” përbën bazën për sistemin kombëtar të OZHQ-ve në Ukrainë. 86 detyra të zhvillimit kombëtar janë përcaktuar dhe vlerat e synuara deri në vitin 2030 janë vendosur

2019

Vendim i Këshillit të Ministrave të Ukrainës, datë 21 gusht 2019, nr. 686 “Çështje të mbledhjes së të dhënave për zbatimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm”

2019, 2020, 2022

Përpara sulmit të plotë nga Federata Ruse në Ukrainë, 3 raporte monitorimi “Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm: Ukraina” janë përgatitur dhe publikuar

183 tregues janë miratuar, për të cilat mblidhen të dhëna për ndjekjen e zbatimit të OZHQ-ve. Krahas kësaj janë përcaktuar edhe përgjegjësit për informacionet.

Shërbimi Shtetëror Statistikor i Ukrainës është ngarkuar si koordinator i mbledhjes së të dhënave dhe ndjekjes së zbatimit të OZHQ-ve dhe zhvillimin e të dhënave mbi të dhënat mbështetur në treguesit e identifikuar

Përgjegjëse për sigurimin e të dhënave dhe llogaritjen e treguesve janë autoritetet e ekzekutivit në nivel qendror, autoritetet shtetërore dhe institucionet shkencore. Gjithsej, 31 autoritete japin të dhëna për raportet

# Raporti i administratorëve



## Urdhri i Ministrisë së Financave, datë 7 dhjetor 2018, nr. 982 “Për miratimin e rekomandimeve metodike për përpilimin e raportit të administratorëve”

Shoqëritë e mëdha dhe emetuesit e letrave me vlerë të pranuar për tregtim në një prej tregjeve të rregulluara të kapitalit apo që ofrohen publikisht në përputhje me ligjin e Ukrainës “Për kontabilitetin dhe raportimin financiar në Ukrainë” përfshihen në njësitë ekonomike me interes publik.

Aktualisht, këto ndërmarrje japin informacione shpjeguese të raportimit të qëndrueshmërisë në raportin e administratorëve në përputhje me kërkesat e Direktivës 2013/34/BE. Raporti i administratorëve është objekt i detyrimit për publikim

Raporti i administratorëve - dokument me informacione financiare dhe jo financiare që përshkruajnë gjendjen dhe perspektivën e zhvillimit të ndërmarrjes dhe jep informacione shpjeguese për rreziqet kryesore dhe pasiguritë e veprimtarisë së saj

Në Ukrainë, raportet e administratorëve dorëzohen nga shoqëri të mëdha dhe të mesme. Njëherazi, ndërmarrjet e mesme mund të përfshijnë vetëm informacione financiare në të. Mikro-ndërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla janë të përjashtuara nga detyrimi për raport të administratorëve

Raporte të administratorëve janë burim informacioni për investitorët e mundshëm dhe publikun në lidhje me vizionin e administratorëve të shoqërisë, që nuk mund të shihet në pasqyrat financiare

Raporti i administratorëve dorëzohet me pasqyrat financiare, nuk i përsëritin pasqyrat financiare dhe shënimet e tyre dhe është një raport i pavarur me qëllimin dhe funksionet e veta



# Direktiva (BE) 2022/2464



1

Raportimi i qëndrueshmërisë i shoqërive tregtare

Direktiva (BE) 2022/2464 për ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 537/2014, Direktivës 2004/109/KE, Direktivës 2006/43/KE dhe Direktivës 2013/34/BE

2

Zbatimi i detyrueshëm në Ukrainë

Zbatimi i detyrueshëm i Direktivës 2022/2464 në Ukrainë përmendet në Raportin e Komisionit Evropian për Ukrainën për vitin 2023

3

Kërkesat e

Direktivës (BE) 2022/2464

Sipas kësaj direktive, një listë e caktuar shoqërisht duhet të përfshijë në një rubrikë më vete të raportit të administratorëve informacionet e nevojshme për të kuptuar ndikimin e shoqërisë në aspektet e zhvillimit të qëndrueshëm, si edhe informacionet e nevojshme për të kuptuar se ndikojnë aspektet e qëndrueshmërisë në rritjen ekonomike, eucirne dhe pozicionin e shoqërisë tregtare

4

Sipas Direktivës 2022/2464 raportimi i qëndrueshmërisë është i detyrueshëm:

- prej 1 janarit 2024 – për ndërmarrjet që zbatojnë Direktivën për raportimin jo financiar 2014/95/BE (ndryshon Direktivën 2013/34/BE);
- prej 1 janarit 2025 – për ndërmarrjet e mëdha;
- prej 1 janarit 2026 - për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të regjistruara në BE;
- prej 1 janarit 2028 - për shoqëritë tregtare jashtë BE-së të cilat kanë degë/filiale

# Standardet Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë (SERQ)



Më 31 korrik 2023, Komisioni Evropian miratoi Rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2023/2772 për plotësimin e Direktivës 2013/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me standardet e raportimit të qëndrueshmërisë.

Me këtë rregullore u miratuan Standardet Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë (SERQ). Shoqëritë tregtare duhet t'i përdorin për të raportuar lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm.

SERQ-të përcaktojnë procedurën për dhënien e informacioneve shpjeguese në këto fusha:



lidhur me ekologjinë – zbutja e pasojave të ndryshimit klimatik; përshtatja me ndryshimet klimatike; burimet ujore dhe detare; përdorimi i burimeve dhe ekonomike me qarkullim të mbyllur; ndotja; biodiversiteti dhe ekosistemet



lidhur me mjedisin shoqëror – mundësi të barabarta për të gjithë; kushtet e punës; respektimi i të drejtave të njeriut



lidhur me administrimin – roli i organeve të administrimit dhe mbikëqyrjes në ndërmarrje; etika tregtare dhe kultura e shoqërisë tregtare; administrimi dhe cilësia e marrëdhënieve me partnerët tregtarë; sistemi i kontrollit të brendshëm dhe sistemi i administrimit të rreziqeve

# Aktet ligjore që rregullojnë raportimin e qëndrueshmërisë në Ukrainë



1

Decree of the President of Ukraine dated September 30, 2019 No. 722 "On the Sustainable Development Goals of Ukraine for the period until 2030"

2

Law of Ukraine "On Accounting and Financial Reporting in Ukraine"

3


The Law of Ukraine "On the Audit of Financial Statements and Auditing Activities"

4

Resolution of the Cabinet of Ministers of Ukraine dated February 28, 2000 No. 419 "On approval of the Procedure for submitting financial statements"

5

Order of the Ministry of Finance dated December 7, 2018. No. 982 "On the approval of Methodological recommendations for drawing up a management report"



# Qëllimi i Strategjisë është

- futja e raportimit të qëndrueshmërisë në Ukrainë brenda vitit 2030, çka do të sigurojë



përshtatjen e legjislacionit të brendshëm me legjislacionin e BE-së në këtë fushë

hyrjen e ndërmarrjeve ukrainase në tregjet e huaja të kapitalit

thithjen e investimeve të huaja

Zbatimi i strategjisë bëhet me arritjen e **2 objektivave strategjikë**:

# Objektivi Strategjik 1: si do të arrihet



1

Zbatimi në Ukrainë i hartimit, dorëzimit dhe publikimit të raportimit të qëndrueshmërisë nga ndërmarrjet në përputhje me Standardet Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë (SERQ)

**Kjo arrihet nëpërmjet:**



zbatimit të kërkesave të legjislacionit evropian për raportimin e qëndrueshmërisë



zbatimit të Standardeve Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë (SERQ) nga ndërmarrjet



futjes në zbatim e një formati elektronik unik të raportimit të qëndrueshmërisë në përputhje me Standardet Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë (SERQ)



zhvillimit të procedurës për dorëzimin dhe publikimin e raporteve të qëndrueshmërisë



përcaktimit të mekanizmit dhe metodave të komunikimit mes autoriteteve shtetërore dhe administratorëve të të dhënave administrative me njësitë ekonomike për të siguruar sqarime dhe konsultime mbi raportimin e qëndrueshmërisë

# Objektivi Strategjik 2: si do të arrihet

2

Futja në zbatim në Ukrainë e procedurave për auditimin e raportimit të qëndrueshmërisë të ndërmarrjeve dhe e një mekanizmi efektiv për ndjekjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të auditimit

Kjo arrihet nëpërmjet:



zgjdhjes ligjore e çështjes së dhënies së sigurisë lidhur me raportimin e qëndrueshmërisë për t'u përdorur nga subjektet e veprimtarisë së auditimit gjatë kryerjes së detyrave përkatëse




përmirësimit të kërkesave për rregullimin e veprimtarisë së auditimit për të siguruar cilësinë e kryerjes së shërbimeve të auditimit për raportimin e qëndrueshmërisë në përputhje me standardet e vendosura ndërkombëtare



kryerjes e masave organizative për të siguruar formimin e specialistëve për kryerjen e auditimeve të raportimit të qëndrueshmërisë dhe përmirësimin e kualifikimeve të tyre.

# Fazat kryesore të zbatimit të Strategjisë





# Rezultatet e pritura të zbatimit të Strategjisë



Zbatimi i strategjisë do të kontribuojë në arritjen e këtyre rezultateve



sigurimi i përputhshmërisë së legjislacionit ukrainas në fushën e raportimit të qëndrueshmërisë me kërkesat e legjislacionit të BE-së në këtë fushë



hartimi në përputhje me Standardet Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë (SERQ), dorëzimi dhe publikimi nga ndërmarrjet i raporteve të qëndrueshmërisë, bashkë me raportin e auditimit mbi përputhshmërinë e raportimit të qëndrueshmërisë me kërkesat e Standardeve Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë (SERQ)



përdoruesit e raportimit të qëndrueshmërisë do të marrin informacione të besueshme dhe objektive, të nevojshme për të vlerësuar aspektet mjedisore dhe shoqërore të veprimtarive të ndërmarrjeve dhe ndikimin e tyre në mjedisin natyror



krijimi i kushteve të barabarta me ato të ndërmarrjeve të BE-së për veprimtarinë e ndërmarrjeve ukrainase në tregjet e huaja të kapitalit



rritja e vëllimit të investimeve të thithura në ndërmarrjet të cilat dorëzojnë dhe publikojnë raporte të qëndrueshmërisë



# Faleminderit!



**CFRR** >>  
Centre for Financial  
Reporting Reform




Public Sector Accounting and Reporting Program

---

PULSAR Program is co-funded by:

 Federal Ministry  
Republic of Austria  
Finance

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
**State Secretariat for Economic Affairs SECO**

---